



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE**

Numri i lëndës: 2023:217754

Datë: 18.12.2023

Numri i dokumentit: 05080061

PPP.nr.14A/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike përmbartimore të kreditores V . Z . , të cilën e përfaqëson av. V . H . nga Prishtina, ndaj debitorit Komuna e Fushë Kosovës, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.260/23, të datës 28.09.2023, të Përmbartuesit Privat E . M . nga Prishtina, jashtë seance, me datë 18.12.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Fushë Kosovës, i paraqitur ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.260/23, të datës 28.09.2023, të Përmbartuesit Privat E . M . nga Prishtina.
- II. ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.260/23, i datës 28.09.2023, i Përmbartuesit Privat E . M . nga Prishtina.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.260/23, me datë 28.09.2023, në të cilin ceket se përmbartimi lejohet në bazë të titullit ekzekutiv Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2493/21, të datës 24.01.2023, i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, me të cilin e ka detyruar debitorin Komunën e Fushë Kosovës që kreditorit t'ia shumën e përgjithshme prej 1.918.38 euro (njëmijëntëqindetëmbëdhjetë euro e tridhjetetë cent), me kamatë ligjore prej 8 %, nga data 25.05.2021 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore aq sa do të arrihen deri në përfundim të procedurës, mirëpo propozimit për përmbartim i është bashkëngjitur Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2388/21, i datës 28.10.2022, i paditëses A . B. Nga Komuna e Fushë Kosovës.

Debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, për shkak se sipas debitorit urdhri përmbartimor është përsëritur te po e njëjta zyre përmbartimore. Tutje shton se që të mos përsëritet gabimi ngase kanë vërejtje nga auditorët për realizimin e dyfishta të aktgjykimeve, obligohen të bëjnë prapësim, me të cilin kanë kërkuar nga gjykata që ta refuzojë urdhrin përmbartimor dhe këtë shprehë të kreditorëve që të ndajnë lëndët në disa procedura përmbartimore, ngase do të ketë keqpërdorim të parasë publike si dhe do të kenë ngatërresë në drejtorinë e financave dhe Thesarin e Kosovës, sepse evidentohet vetëm një aktgjykim dhe numër i tij.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se me datë 11.07.2023 kreditori ka iniciuar propozim për përmbartim vetëm për shpenzimet e procedurës kontestimore që janë vendosur me këtë aktgjykim. Ndërsa për borxhin kryesor ka iniciuar procedurën përmbartimore në gjykatë, sepse sipas mendimit juridik të Gjykatës Supreme për kompensimin nga marrëdhënia e punës ishte kompetente gjykata, mirëpo për shpenzime procedurale kishte kompetencë përmbartuesi. Tutje ka shtuar se me datë 28.08.2023 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 08/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-118, i cili ka hyrë në fuqi me 28.08.2023, apo 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare, i cili ka paraparë që *“7. Përmbartuesi privat është kompetent për të vendosur në procedurën e përmbartimit dhe zbatimin e përmbartimit të vendimeve gjyqësore, lidhur me kompensimet nga marrëdhënia e punës”*. Tutje ka shtuar se duke pasur parasysh këtë fakt juridik, kreditorja ka tërhequr propozimin për përmbartim për borxhin kryesor të parashtruar në gjykatë dhe ka iniciuar procedurën përmbartimore tek përmbartuesi privat në përputhje me dispozitën ligjore të cekur sipër, duke kërkuar kompensimin edhe për borxhin kryesor, e cila procedurë përmbartimore zhvillohet sipas këtij numri, pra P.nr.260/2023, e tani e tutje, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore më sipër, nuk ka asnjë arsye që këto procedura të ndahen, sepse kompetencë ka vetëm përmbartuesi privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga shkresat e lëndës shihet se kreditor në këtë çështje juridike përmbartimore paraqitet kreditorja V . Z . , ndërsa dokumenti përmbartimor që i është bashkëngjitur propozimit për përmbartim është Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2388/21, i datës 28.10.2022, në të cilën si palë paditëse figuron A . B. nga fshati Harilaq, Komuna e Fushë Kosovës, e jo këtu kreditorja V . Z . .

Me nenin 71, parag. 1, nënparag. 1.6., të LPP-së është paraparë se *“Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse... 1.6. kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin kundër debitorit”*.

Gjykata këtë nuk ka mundur ta trajtojë si gabim teknik të përfaqësuesit të kreditores apo përmbaruesit privat, dhe nuk ka pasur mundësi të vendosë ndryshe, pasi që nga shkresat e lëndës shihet se e gjithë procedura është zhvilluar me këtë dokument përmbarimor, në të cilin si palë figuron dikush tjetër e jo tani kreditorja.

Nga arsyet e theksuara më lart, gjykata në bazë të nenit 73 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

PPP.nr.14A/23, me datë 18.12.2023.

Gjyqtari

\_\_\_\_\_  
Freskim Musliu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.